

**MARINA RESIDENCES VLORE**  
**TIRANE FARKE LUNDER LOBBY HOME, RRUGA NACIONALE**  
**TIRANE- ELBASAN, PERBALLE QENDRES TREGTARE TEG**  
**M12103049U**

Sot, më datë 23/05/2019 në selinë e Shoqërisë "**Marina Residences Vlorë**" sh.p.k. me NUIS M12103049U (më tej referuar si "Shoqëria"), në adresën "Tirane Farke Lunder Lobby Home, Rruga Nacionale Tirane-Elbasan, Perballe Qendres Tregtare TEG" u paraqitën palët e mëposhtme ortake të Shoqërisë:

- "**Marina Di Valona**" sh.p.k. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit me NUIS M01324008A me seli në adresën: "Tirane Farke Lunder Lobby Home, Rruga Nacionale Tirane- Elbasan, Perballe Qendres Tregtare TEG", përfaqësuar nga administratori Eranda Muskaj - ortak i Shoqërisë dhe zotërues e 80% ( tetëdhjetë përqind) e kuotave të kapitalit themeltar të saj ( ne vijim "**Marina di Valona**")
- "**Brunes**" sh.p.k. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit me NUIS M01324008A me seli në adresën: "Tirane Farke Lunder Lobby Home, Rruga Nacionale Tirane - Elbasan, Perballe Qendres Tregtare TEG", përfaqësuar nga administratori Geront Çela - ortak i Shoqërisë dhe zotërues e 20% ( njëzet përqind) e kuotave të kapitalit themeltar të saj (ne vijim "**Brunes**").

Z. Eranda Muskaj, i cili merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Rozana Kodrari, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit

Z. Eranda Muskaj në cilësinë e Kryetarit, verifikon vullnetin e ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, duke e deklaruar Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**Rendi i Ditës**

**I. Miratimi i zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë.**

\*\*\*\*\*

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron domosdoshmërine e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë me një vlerë prej 27,229,375 LEK (njëzet e shtatë milionë lekë e dyqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë lekë), në sajë të ecurisë së projektit të ndërtimit të zhvilluar prej saj (në vijim "**Zmadhimi i Kapitalit**"). Në bazë të nenit 2.01 të Statutit të Shoqërisë Ortakët duhet të nënshkruajnë dhe shlyejnë Zmadhimin e Kapitalit në proporcion me kuotën e zotëruar prej tyre në Shoqëri. Më konkretisht:

- Marina di Valona duhet të nënshkruajë dhe shlyejë një zmadhim kapitali prej 21.783.500 lek (në vijim "**Zmadhimi i Kapitalit MRV**"); dhe
- Brunes duhet të nënshkruajë dhe shlyejë një zmadhim kapitali prej 5,445,875 LEK ( pesë milionë e katërqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë lekë) (në vijim "**Zmadhimi i Kapitalit MRV** ").

Në datën e sotme Marina di Valona gëzon ndaj Shoqërisë një të drejtë kredie bazuar në:



- (i) Kontratën e Huasë të lidhur mes tyre me datë 21.10.2021 me një vlerë kreditimi prej
  - (ii) 500, 000 ( pesëqind mijë ) LEK;
  - (iii) Kontratën e Huasë të lidhur mes tyre me datë 21.01.2022 me një vlerë kreditimi prej 15, 000 (pesëmbëdhjetë mijë lekë) EUR e cila, bazuar ne kursin e kembimit eur- lek 121. 62, rezulton në vlere te barabarte me 1,824,300 LEK ( një milionë e tetëqind e e njëzet e katër mijë e treqind lekë); dhe
  - (iv) Kontratën e Huasë të lidhur mes tyre me datë 21.01.2022 me një vlerë kreditimi prej 160, 000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë euro) EUR e cila, bazuar ne kursin e kembimit eur- lek 121. 62, rezulton në vlere te barabarte me 19,459,200 LEK (nëntëmbëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind lekë);
- për një vlerë totale kreditimi në LEK 21,783,500 LEK (njëzet e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind lekë) (në vijim "Huaja MRV").

Ne datën e sotme Brunes gëzon ndaj Shoqërisë një të drejtë kredie bazuar në Kontratën e Huasë të lidhur mes tyre me datë 14.02.2022 me një vlerë kreditimi prej 40, 000 (dyzet mijë) EUR e cila, bazuar ne kursin e kembimit eur- lek 121. 62, rezulton në vlere te barabarte me 4,864,800 LEK ( katër milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind lekë) (në vijim "Huaja Brunes").

Për sa më sipër, Ortakët e Shoqërisë dëshirojnë të nënshkruajnë dhe shlyejnë Zmadhimin e Kapitalit nëpërmjet konvertimit të Huasë MDIV dhe Huasë Brunes dhe pjesën e mbetur nëpërmjet kontributit në para Brunes prej 581,075 LEK (pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e pesë lekë).

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

**VENDOS:**

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë me vlerën totale 27,229,375 LEK (njëzet e shtatë milionë lekë e dyqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë lekë).
- B. Të miratojë nënshkrimin dhe shlyerjen e Zmadhimit të Kapitalit nga Ortakët si vijon:
  - (i) Marina di Valona sh.p.k do të nënshkruajë dhe shlyejë Zmadhimin e Kapitalit në një vlerë prej 21,783,500 LEK (njëzet e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind lekë) nëpërmjet konvertimit të Huasë MRV.
  - (ii) Brunes sh.p.k. të nënshkruajë dhe shlyejë Zmadhimin e Kapitalit në një vlerë prej 5,445,875 LEK ( pesë milionë e katër qind e dyzet e e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë lekë), prej të cilave 4,864,800 LEK ( katër milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind ) do të shlyhen nëpërmjet konvertimit të Huasë MRV dhe 581,075 LEK ( pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e pesë) nëpërmjet kontributit në para do te pagueshëm brenda 5 ditë pune nga miratimi i këtij vendimi.
- C. Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit do të jetë në vlerën totale prej 27,230.375 LEK ( njëzet e shtatë milionë e dyqind e tridhjetë mije e treqind e shtatëdhjetë e pese lekë).
- D. Të autorizojë Administratorin që në emër dhe për llogari të Shoqërisë të kryejë gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

\*\*\*\*\*

Meqenëse nuk kishte çështje të tjera për tu shqyrtuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur. Ky Vendim i Shoqërisë, i mbajtur në formën e procesverbalit, nënshkruhet rregullisht në përputhje me



parashikimet e nenit 90/3 të Ligjit nr. 9901., datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nga Sekretari dhe Kryetari i Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE E SHOQËRISË  
"Marina Residences Vlorë" sh.p.k**

**Listë Prezenca**

EMRI	CILËSIA	POZICIONI NË ASAMBLE
Eranda Muskaj	Përfaqësuese ligjore e Ortakut Marina di Valona sh.p.k.	Kryetar
Geront Çela	Përfaqësues ligjor i Ortakut Brunës sh.p.k.	Anëtar i Pranishëm
Rozana Kodrari	Konsulent ligjor	Sekretar

FIRMA  
MARINA DI VALONA  
Eranda Muskaj  
M01374/08  
MARINA DI VALONA sh.p.k  
K3712/0374  
Durrës - Albania

... ..

... ..

... ..

... ..	... ..	... ..
...	...	...
...	...	...
...	...	...



MARINA DI VAL  
MOLISSE

... ..  
Dunas - Albania